

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E DIGJITALIZIMIT DHE ADMINISTRATES PUBLIKE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 202-26-6862-2-2-1

Sa i përket tenderit për *“Mirëmbajtja dhe përditësimi i Sistemit Elektronik për Organizata Joqeveritare (SEOJQ)”*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	PBC SH.P.K.
NUI	810845985
Adresa	Rruga Bekim Fehmiu, 91
Vendi	Prishtinë
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	044467467
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Bashkim Selmani
Adresa elektronike	bs@pbc.group
Data e parashtrimit të ankesës	10.09.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Ankesa i përket grupeve:

“Mirëmbajtja dhe përditësimi i Sistemit Elektronik për Organizata Joqeveritare (SEOJQ)”

Njoftimi për kontratë: 18.08.2026

Pyetjet e dorëzuara: 25.08.2026

Kërkesa për rishqyrtim: 01.09.2026

Vendimi për kërkesën për rishqyrtim: 04.09.2026

Afati fillestar për dorëzimin e ofertave: 08.09.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim është dorëzuar më datë 01.09.2026, ndërsa vendimi i AK-së për kërkesën për rishqyrtim është publikuar më datë 04.09.2026.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 i Ligjit për Prokurim Publik;

Neni 9.1 dhe neni 27.1 i Ligjit për Prokurim Publik;

Neni 28.1 dhe neni 28.8 i Ligjit për Prokurim Publik;

Neni 51.1 dhe neni 51.3 i Ligjit për Prokurim Publik;

Neni 69.1 dhe neni 69.4 i Ligjit për Prokurim Publik;

Neni 70 i Ligjit për Prokurim Publik;

Neni 19.1, neni 19.3 dhe neni 19.4 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik;

Neni 25.17 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. Hyrje

PBC, në cilësinë e operatorit ekonomik me interes të drejtpërdrejtë për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit, pas përfundimit të procedurës paraprake sipas nenit 108/A të LPP-së, paraqet këtë ankesë pranë OSHP-së kundër:

1. Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 04.09.2026; dhe

2. Dosjes së Tenderit, e cila:

- përmban kritere të kualifikimit të paarsyetuara si të domosdoshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, të cilat kufizojnë konkurrencën dhe mund të krijojnë avantazh të pajustificuar për OE të caktuar;
- përmban specifikime teknike dhe detyrime kontraktuale të paqarta, të papërcaktuara dhe të pamatshme, pa sasi, kufij maksimalë, parametra teknike dhe kritere objektive të pranimi, duke cenuar përgatitjen dhe krahasueshmërinë e ofertave;

II. Dispozitat e shkelura

- Neni 7 i LPP-së – trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi dhe ruajtja e konkurrencës;
- Neni 9.1 dhe neni 27.1 i LPP-së – përcaktimi i nevojës, fushëveprimit dhe informatave/kushteve materiale të kontratës;
- Neni 28.1 dhe 28.8 i LPP-së – specifikimet teknike dhe kërkesat funksionale/ekzekutuese duhet të përcaktohen paraprakisht dhe me saktësi të mjaftueshme që tenderuesit të mund ta përcaktojnë lëndën e kontratës;
- Nenet 51.1 dhe 51.3 të LPP-së – kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen në ato që janë të nevojshme dhe të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës;
- Nenet 69.1 dhe 69.4 të LPP-së – aftësia teknike dhe profesionale duhet të vlerësohet në raport me shkathtësitë, kapacitetin, përvojën dhe kualifikimet relevante për realizimin e kontratës;
- Neni 70 i LPP-së – lidhur me standardet e sigurimit të cilësisë dhe pranimin e certifikatave ose dëshmive të barasvlershme;
- Nenet 19.1, 19.3 dhe 19.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik – specifikimet teknike duhet të përcaktojnë karakteristikat e detyrueshme të objektit dhe të jenë të qarta, të sakta dhe precize;
- Neni 25.17 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik – kërkesat minimale të kualifikimit duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.

III. Vendimi i AK-së dhe Dosja e publikuar më 04.09.2026

Me Vendimin e datës 04.09.2026, AK e ka aprovuar pjesërisht kërkesën për rishqyrtim. Megjithatë, në dosjen e publikuar nuk ka asnjë ndryshim përmbajtësor në kriteret e kualifikimit apo në specifikimet teknike të kontestuara. Ndryshimi i vetëm i evidentuar është shtyrja e afatit për dorëzimin dhe hapjen e tenderëve nga data 08.09.2026 në datën 15.09.2026, ora 14:00.

IV. Pretendimet ankimore

PBC i mban pretendimet materiale të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim të datës 01.09.2026. Ato paraqiten më poshtë në formën: fakt - bazë ligjore - prova - përfundim.

Pretendimi 1 - Kriteri arsimor për pozitat e kontestuara është i paarsyetuar, joproporcional dhe kufizon konkurrencën:

Për Menaxherin e Projektit, Analistin e Sistemit, Arkitektin e Softuerit dhe Ekspertin Web Services/Web API kërkohet Master/MSc ose diplomë e sistemit të vjetër katërvjeçar. Këto role njëkohësisht kushtëzohen me përvojë relevante dhe, për Menaxherin e Projektit, edhe me certifikim profesional. Dosja nuk identifikon detyrë konkrete që nuk mund të kryhet nga një ekspert me Bachelor relevant dhe përvojën e kërkuar.

Për të njëjtin sistem, dosja e vitit 2022 kërkonte për Menaxherin e Projektit dhe Zhvilluesin e Softuerit diplomë universitare në Shkenca Kompjuterike, pa e vendosur Master/MSc si kusht eliminues. Për pozitat e reja, proporcionaliteti duhet të vlerësohet sipas detyrave konkrete. **Kriteri aktual e ngushton konkurrencën pa arsytim të dokumentuar, në kundërshtim me nenet 7, 51 dhe 69 të LPP-së dhe nenin 25.3 të Rregullores.**

Për Menaxherin e Projektit, AK në Vendimin e datës 04.09.2026 arsyeton se:

"Kriteri është përcaktuar për shkak të përgjegjësisë së rolit në menaxhimin dhe koordinimin e një sistemi kompleks, të integruar me sisteme dhe regjistra të tjerë shtetërorë."

Ky arsyetim përshkruan **përgjegjësinë dhe kompleksitetin e pozitës**, por nuk arsyeton **domosdoshmërinë e nivelit akademik Master**. AK nuk ka identifikuar se cila njohuri apo kompetencë specifike, e domosdoshme për menaxhimin dhe koordinimin e këtij projekti, fitohet ose dëshmohet vetëm përmes diplomës Master dhe nuk mund të përmbushet nga një diplomë Bachelor në drejtim relevant ose ekuivalent.

Rrjedhimisht, AK nuk ka dëshmuar pse **niveli Master është i nevojshëm dhe drejtpërdrejt relevant për realizimin e detyrave të Menaxherit të Projektit**, dhe as pse të njëjtat detyra nuk mund të realizohen nga një ekspert me diplomë Bachelor në drejtim ekuivalent **me certifikim dhe me përvojën e kërkuar**.

Për Analistin e Sistemit, AK në Vendimin e datës 04.09.2026 arsyeton se:

"Analisti i Sistemit kërkon analizë të proceseve dhe kërkesave komplekse, modelim të zgjidhjeve dhe vlerësim të ndikimit të ndryshimeve në sistem. Për këtë arsye kërkohet kualifikimi i përcaktuar në DT, së bashku me përvojën profesionale të kërkuar."

Edhe ky arsyetim përshkruan **detyrat dhe përgjegjësinë e pozitës**, por nuk shpjegon pse pikërisht niveli akademik Master është domosdoshmërisht i nevojshëm për realizimin e tyre. AK **nuk identifikon ndonjë njohuri ose kompetencë specifike** për analizën e proceseve, modelimin e zgjidhjeve apo vlerësimin e ndikimit të ndryshimeve, **e cila fitohet ose dëshmohet vetëm me diplomë Master** dhe nuk mund

të përmbushet nga një ekspert me diplomë Bachelor relevant dhe përvojën profesionale të kërkuar.

Rrjedhimisht, AK nuk ka dëshmuar pse **niveli Master është i nevojshëm dhe drejtpërdrejt relevant për realizimin e detyrave të Analistit të Sistemit**, dhe as pse këto detyra nuk mund të realizohen nga një ekspert me diplomë Bachelor në drejtim ekuivalent dhe me përvojën e kërkuar.

Për Arkitektin e Softuerit, AK në Vendimin e datës 04.09.2026 arsyeton se:

"Arkitekti i Softuerit ka përgjegjësi për strukturën teknike të zgjidhjes, integrimet, performancën, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit; prandaj kërkohet kualifikimi i përcaktuar në DT, si dhe përvoja përkatëse profesionale."

Edhe në këtë rast, AK përshkruan **përgjegjësitë teknike të pozitës**, por nuk identifikon se cila njohuri apo kompetencë specifike për arkitekturën, integrimet, performancën, sigurinë apo qëndrueshmërinë e sistemit kërkon domosdoshmërisht nivelin Master dhe nuk mund të përmbushet nga një ekspert me nivelin Bachelor relevant dhe përvojën profesionale të kërkuar.

Rrjedhimisht, AK nuk ka dëshmuar pse **niveli Master është i nevojshëm dhe drejtpërdrejt relevant për realizimin e detyrave të Arkitektit të Softuerit**, dhe as pse të njëjtat detyra nuk mund të realizohen nga një ekspert me diplomë Bachelor në drejtim ekuivalent dhe me përvojën e kërkuar.

Për Ekspertin për zhvillimin dhe konfigurimin e Ueb shërbimeve dhe Web API, AK në Vendimin e datës 04.09.2026 deklaron se:

"Për këtë pozitë, sipas Termave të Referencës, kërkohet diplomë universitare Bachelor në Shkenca Kompjuterike, Inxhinieri Kompjuterike ose ekuivalente, së bashku me minimum 3 vite përvojë në Ueb-shërbime/Web API dhe së paku një projekt të ngjashëm në platformën Microsoft."

Ky konstatim i AK-së nuk përputhet me Dosjen e Tenderit. Si në versionin fillestar, ashtu edhe në Dosjen e publikuar më 04.09.2026, kërkesa vazhdon të jetë: *"Diplomë Universitare, Inxhinier i Kompjuterikës me telekomunikacion ose Master i shkencave kompjuterike ose Master i inxhinierisë kompjuterike ose ekuivalente"*. Pra, pavarësisht deklarimit të AK-së në Vendim, kriteri në FDT ka mbetur i pandryshuar.

Për të njëjtin sistem, Dosja e Tenderit e vitit 2022 kërkonte për Menaxherin e Projektit dhe Zhvilluesin e Softuerit **diplomë universitare në Shkenca Kompjuterike, pa e vendosur nivelin Master si kusht eliminues**. Për pozitat e shtuara në procedurën aktuale, proporcionaliteti duhet të vlerësohet në raport me detyrat konkrete dhe jo vetëm me emërtimin, rëndësinë apo kompleksitetin e pozitës.

Baza ligjore. Sipas nenit 51.1 dhe 51.3 të LPP-së, kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen në ato që janë të nevojshme dhe duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës. Po ashtu, sipas nenit 69.1 dhe, në veçanti, nenit 69.4 të LPP-së, aftësia teknike dhe profesionale për kontratat e shërbimeve vlerësohet në raport me shkathtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë profesionale, ndërsa kualifikimi shkollor dhe profesional përbën vetëm një nga elementet përmes të cilave mund të dëshmohet kjo aftësi. Vendosja

e një kriteri akademik kufizues, pa arsyetuar domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e tij në raport me detyrat konkrete të pozitës, cenon parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës sipas nenit 7 të LPP-së. Të njëjtin standard të proporcionalitetit për kërkesat minimale e përcakton edhe neni 25.17 i Rregullores për Prokurimin Publik.

Provat mbi të cilat mbështetet pretendimi

- Dosja e Tenderit e procedurës aktuale, versioni fillestar dhe versioni i publikuar më 04.09.2026, në veçanti kërkesat për pozitat e kontestuar;
- Informatat/sqarimet shpesh të publikuara nga Autoriteti Kontraktues në kuadër të kësaj procedure, për atë që lidhet me kërkesat dhe kriteret e kontestuar;
- Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 04.09.2026 mbi kërkesën për rishqyrtim, në veçanti arsyetimet e dhëna për secilën pozitë;
- Dosja e Tenderit e vitit 2022 për të njëjtin sistem, për qëllim të krahasimit të kriterëve arsimorë dhe vlerësimit të proporcionalitetit të kërkesave aktuale;
- Raporti i Ekspertit Shqyrtues/Teknik në lëndën e OSHP-së nr. 2026/0645.

Përfundimi dhe kërkesa. Duke u bazuar në faktet, argumentet, bazën ligjore dhe provat e paraqitura më sipër, kërkojmë nga OSHP që këtë pretendim ta aprovojë si të bazuar dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që, për pozitat e kontestuar, të përcaktojë si kusht minimal arsimor **diplomën Bachelor në drejtime relevante ose ekuivalente**, krahas përvojës profesionale të kërkuar për secilën pozitë.

Pretendimi 2 – Kërkesa për numrin e stafit është e paarsyetuar, joproporcionale dhe kufizon konkurrencën:

Procedura e vitit 2022 për të njëjtin sistem, me kohëzgjatje 36 muaj, kërkonte dy persona kyç. Procedura aktuale kërkon së paku shtatë persona/profile. Ndërkohë, edhe dosja e vitit 2022 përfshinte integrimin me e-Kosova, API dhe endpoint-e, Web Services, interoperabilitetin, mirëmbajtjen, trajnimin, manualët dhe videot.

Dosja aktuale nuk përmban vëllim të matshëm të punës, numër të parashikuar të kërkesave ose ndarje të detyrave që e arsyeton këtë rritje. Pa një arsyetim të tillë dhe pa mundësi për kombinimin e roleve kur plotësohen kompetencat, kriteri e kufizon konkurrencën dhe krijon avantazh për operatorët që disponojnë paraprakisht konfigurimin specifik të kërkuar.

Për numrin e stafit, AK në Vendimin e datës 04.09.2026 arsyeton se:

“Numri i stafit është përcaktuar në përputhje me fushëveprimin e SEOJQ-së si sistemi i centralizuar për ofrimin e shërbimeve për OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë mirëmbajtjen, integrimet, analizën, arkitekturën dhe avancimin e sistemit, dhe mbetet i njëjti si në Njoftim për Kontratë dhe DT dhe është në harmoni të plotë me natyrën dhe kompleksitetin e AP-së.”

Ky arsyetim përshkruan **fushëveprimin dhe kompleksitetin e sistemit**, por nuk shpjegon pse realizimi i këtyre detyrave kërkon domosdoshmërisht **së paku shtatë persona/profile të veçanta**. AK nuk ka paraqitur vëllim të matshëm të punës, numër të parashikuar të kërkesave, ngarkesë të punës për secilin profil apo ndarje konkrete të detyrave që do ta arsyetonte këtë numër.

Po ashtu, AK nuk e ka trajtuar në mënyrë konkrete mundësinë e **kombinimit të roleve kur i njëjti ekspert i plotëson kriteret dhe kompetencat për më shumë se një profil**. Nuk është shpjeguar se cilat role duhet të ushtrohen domosdoshmërisht njëkohësisht nga persona të ndryshëm apo cila ngarkesë konkrete e punës e pamundëson kombinimin e tyre.

Fakti se kërkesa është e njëjtë në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit dëshmon vetëm përputhshmërinë formale të dokumenteve, por **nuk dëshmon nevojën dhe proporcionalitetin e vetë kriterit**.

Kjo merr rëndësi të veçantë kur krahasohet me procedurën e vitit 2022 për **të njëjtin sistem**, e cila kishte kohëzgjatje 36 muaj dhe kërkonte vetëm dy persona kyç, ndonëse përfshinte gjithashtu integrimin me e-Kosova, API dhe endpoint-e, Web Services, interoperabilitetin, mirëmbajtjen, trajnimin, manualët dhe videot.

OE ankues nuk pretendon se AK duhet të mbajë domosdoshmërisht të njëjtin numër të stafit si në vitin 2022. Megjithatë, rritja nga **dy persona kyç në së paku shtatë persona/profile** duhet të mbështetet në ndryshime konkrete dhe të dokumentuara në vëllimin, natyrën ose organizimin e punës. Një arsyetim i tillë nuk është paraqitur.

Baza ligjore. Sipas nenit 51.1 dhe 51.3 të LPP-së, kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen në ato që janë të nevojshme dhe duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës. Po ashtu, sipas nenit 69.1 dhe, në veçanti, nenit 69.4 të LPP-së, aftësia teknike dhe profesionale për kontratat e shërbimeve vlerësohet në raport me shkathtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë profesionale. Përcaktimi i një numri minimal të stafit, pa arsyetuar lidhjen e tij me vëllimin real të punës dhe detyrat konkrete të kontratës, cenon parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës sipas nenit 7 të LPP-së. Të njëjtin standard të proporcionalitetit për kërkesat minimale e përcakton edhe neni 25.17 i Rregullores për Prokurimin Publik.

Provat mbi të cilat mbështetet pretendimi

- Dosja e Tenderit e procedurës aktuale, versioni fillestar dhe versioni i publikuar më 04.09.2026, në veçanti kërkesa për numrin dhe profilet e stafit;
- Informatat/sqarimet shitesë të publikuara nga Autoriteti Kontraktues në kuadër të kësaj procedure, për aq sa lidhen me kërkesat për stafin;
- Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 04.09.2026 mbi kërkesën për rishqyrtim, në veçanti arsyetimi i dhënë lidhur me numrin e stafit;
- Dosja e Tenderit e vitit 2022 për të njëjtin sistem, për qëllim të krahasimit të numrit të personelit kyç, fushëveprimit të shërbimeve dhe vlerësimit të proporcionalitetit të kërkesës aktuale;

- Raporti i Ekspertit Shqyrtues/Teknik në lëndën e OSHP-së nr. 2026/0645.

Përfundimi dhe kërkesa.

Duke u bazuar në faktet, argumentet, bazën ligjore dhe provat e paraqitura më sipër, kërkojmë nga OSHP që këtë pretendim ta aprovojë si të bazuar dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që kërkesën për numrin dhe konfigurimin e stafit ta përcaktojë në përputhje me vëllimin real të punës dhe detyrat konkrete të kontratës, si dhe të mundësojë kombinimin e roleve kur i njëjti ekspert i plotëson kriteret dhe kompetencat e kërkuara, përveç rasteve kur AK arsyeton konkretisht se natyra, ngarkesa apo organizimi i punës kërkon angazhimin e personave të veçantë.

Pretendimi 3 – Kërkesa për ISO/IEC 20000-1:2018 dhe certifikimet kumulative është e paarsyetuar dhe joproportionale

Kërkesa për ISO/IEC 20000-1:2018 dhe kërkitimi kumulativ i certifikimeve nga anëtarët e grupit nuk janë lidhur me detyra ose rreziqe konkrete të kontratës. Hostimi i sistemit mbetet nën përgjegjësinë e DOJQ/ASHI, ndërsa dosja nuk shpjegon pse standardi kërkohet si kusht eliminues për këtë fushëveprim.

Certifikimet duhet të kërkohen vetëm në masën që janë relevante për shërbimin dhe nga anëtari i grupit që e realizon pjesën përkatëse. Në mungesë të këtij arsytimi, kërkesa nuk është dëshmuar si proporcionale sipas neneve 7, 51 dhe 69 të LPP-së dhe nenit 25.3 të Rregullores.

Për certifikimet ISO, AK në sqarimet e datës 03.09.2026 ka deklaruar se:

“ISO/IEC 20000-1:2018 kërkohet për menaxhimin e shërbimeve TI, përfshirë përkrahjen, incidentet, vazhdimësinë dhe përmirësimin e shërbimeve. Është plotësues ndaj ISO 9001 dhe ISO/IEC 27001. Certifikimet ISO të kërkuara në DT i referohen Operatorit/eve Ekonomik dhe jo secilit anëtar individual të stafit.”

Ky arsyetim tregon vetëm lidhjen e përgjithshme të standardit me shërbimet TI, por **nuk dëshmon pse ISO/IEC 20000-1:2018 duhet të jetë kusht eliminues për këtë kontratë konkrete.** AK nuk ka identifikuar detyrën ose rrezikun specifik që e bën këtë certifikim të domosdoshëm.

Për më tepër, Dosja përcakton se **hostimi dhe publikimi i SEOJQ-së mbetet nën përgjegjësinë e DOJQ/ASHI**, ndërsa njëkohësisht kërkon që, kur të gjithë anëtarët e grupit angazhohen në ofrimin e shërbimit, të gjithë të jenë të certifikuar me ISO 9001, ISO 27001 dhe IEC 20000-1:2018.

Prandaj, nuk kontestohet relevanca e përgjithshme e këtij standardi me shërbimet TI; **kontestohet domosdoshmëria dhe proporcionaliteti i tij si kriter eliminues**, e cila nuk është arsyetuar konkretisht nga AK.

Baza ligjore. Sipas neneve 51.1 dhe 51.3 të LPP-së, kriteret duhet të jenë të nevojshme, drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës. Nenet 69 dhe 70 të LPP-së kërkojnë që dëshmitë për aftësinë teknike dhe standardet e cilësisë të lidhen me nevojat reale të kontratës dhe të respektohet parimi i ekuivalencës. Vendorsja e një certifikimi specifik si kusht eliminues pa arsyetim konkret cenon

konkurrencën dhe trajtimin e barabartë sipas nenit 7 të LPP-së. Të njëjtin standard proporcionaliteti e përcakton edhe neni 25.17 i Rregullores.

Provat mbi të cilat mbështetet pretendimi

- Dosja e Tenderit e publikuar më 04.09.2026;
- Kërkesa për informacione/sqarime shtesë dhe përgjigjja nr. 6 e AK-së;
- Vendimi i AK-së i datës 04.09.2026 mbi kërkesën për rishqyrtim;
- Termat e Referencës, në pjesën që përcakton përgjegjësinë e DOJQ/ASHI për hostimin e sistemit.

Përfundimi dhe kërkesa. Duke u bazuar në faktet, argumentet dhe provat e mësipërme, kërkojmë nga OSHP që këtë pretendim ta aprovojë si të bazuar dhe ta obligojë AK-në që **ta largojë ISO/IEC 20000-1:2018 si kriter eliminues.**

Pretendimi 4 – Specifikimet teknike janë të hapura, të pamatshme dhe nuk përcaktojnë qartë fushëveprimin e kontratës

Aneksi 1 përdor formulime të hapura, si “sipas kërkesave”, “kërkesa tjera”, “varësisht nga kërkesa”, “sipas nevojës” dhe “avancim teknologjik konform zhvillimeve teknologjike”, pa përcaktuar kufij sasiorë ose funksionalë. Në veçanti, nuk janë përcaktuar:

- numri maksimal i formave, proceseve dhe kërkesave të reja;
- numri i funksioneve Backend/API, endpoint-eve dhe integriteteve;
- versionet aktuale dhe të synuara të .NET, SQL Server dhe komponentëve të tjerë;
- kategoritë e incidenteve dhe SLA-të përkatëse;
- numri dhe kohëzgjatja e trajnimeve;
- rezultatet e dorëzueshme dhe kriteret objektive të pranimit.

Pa këto të dhëna, OE-të detyrohen të planifikojnë burimet mbi supozime të ndryshme dhe ofertat nuk mund të përgatiten e krahasohen mbi baza të njëjta. Kjo është në kundërshtim me nenet 7 dhe 28 të LPP-së dhe nenin 19.3–19.4 të Rregullores.

Për specifikimet teknike, AK në Vendimin e datës 04.09.2026 është përgjigjur:

“Referoju dosjes së Tenderit Aneksit 1 të DT-së.”

Kjo përgjigje nuk e trajton substancën e pretendimit. Referimi në Aneksin 1 nuk tregon se ku janë përcaktuar sasitë, kufijtë maksimalë dhe parametrat e matshëm të kërkuar. Përkundrazi, vetë Dosja vazhdon të përdorë formulime të hapura dhe të lërë një pjesë të fushëveprimit të përcaktohet sipas kërkesave gjatë zbatimit.

Praktika konkrete e OSHP-së. Në lëndën nr. **2025/0780**, eksperti konstatoi se mungesa e numrit minimal të moduleve dhe nënmoduleve, paramasave të

avancimeve, trajnimeve, ndërlidhjeve dhe kufijve të punës e bënte objektin e kontratës të papërcaktuar dhe cenonte konkurrencën e barabartë. Eksperti përfundoi se mungesa e specifikimeve minimale dhe kriterëve të pranimit kërkonte plotësimin e Dosjes së Tenderit me specifikime të qarta funksionale dhe jofunksionale. Me Vendimin nr. **2025/0780**, OSHP e aprovoi ankesën si të bazuar, anuloi Njoftimin për Kontratë dhe obligoi AK-në të përmirësojë Dosjen e Tenderit.

Edhe pas korigjimeve, në lëndën nr. **2025/1198**, eksperti konstatoi se lënia e parametrave të ardhshëm në diskrecionin e AK-së e mbante objektin të papërcaktuar në vëllim dhe kompleksitet dhe se Dosja duhet të përmbajë specifikime teknike minimale dhe kufij të qartë për punët shtesë. Në këtë lëndë eksperti rekomandoi përmirësimin e Dosjes së Tenderit dhe zgjatjen e afatit, ndërsa të dyja palët u pajtuan me raportin e ekspertit.

Të njëjtin standard e konfirmon edhe **Raporti i Ekspertit Shqyrtues/Teknik në lëndën e OSHP-së nr. 2026/0645, datë 03.09.2026**, ku eksperti ka vlerësuar se nuk është e domosdoshme që AK të përcaktojë paraprakisht çdo hollësi të dizajnit dhe implementimit teknik, por është e domosdoshme të përcaktojë minimumin e fushëveprimit që përfshihet në çmimin e ofertës, si dhe ndarjen e përgjegjësisë dhe rreziqeve.

Baza ligjore. Sipas nenit 28.1 dhe 28.8 të LPP-së, specifikimet teknike dhe kërkesat funksionale duhet të përcaktohen paraprakisht dhe me saktësi të mjaftueshme që tenderuesit të mund ta përcaktojnë lëndën e kontratës. Po ashtu, nenet 19.1, 19.3 dhe 19.4 të Rregullores kërkojnë që specifikimet teknike të përcaktojnë karakteristikat e detyrueshme të objektit dhe të jenë **të qarta, të sakta dhe precize**, pa krijuar paqartësi lidhur me natyrën e shërbimeve të kërkuara.

Nuk pretendohet se AK duhet të përcaktojë paraprakisht çdo hollësi të implementimit teknik. Megjithatë, para ofertimit duhet të jenë të përcaktuara së paku **kërkesat minimale, fushëveprimi dhe kufijtë e punës që përfshihen në çmimin e ofertës**, në mënyrë që të gjithë OE-të të mund të planifikojnë resurset, të vlerësojnë rrezikun dhe të kalkulojnë ofertat mbi baza të njëjta dhe të krahasueshme.

Provat mbi të cilat mbështetet pretendimi

- Dosja e Tenderit e procedurës aktuale, versioni fillestar dhe versioni i publikuar më 04.09.2026, në veçanti Aneksi 1 dhe specifikimet teknike të kontestuar;
- Informatat/sqarimet shtesë të publikuara nga Autoriteti Kontraktues në kuadër të kësaj procedure, për aq sa lidhen me fushëveprimin, avancimet, integritet, SLA-të, trajnimet dhe kërkesat tjera teknike;
- Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 04.09.2026 mbi kërkesën për rishqyrtim, në veçanti përgjigjja lidhur me pretendimin 3.5 – Specifikimet teknike;
- Raporti i Ekspertit Shqyrtues/Teknik në lëndën e OSHP-së nr. **2026/0645**, datë 03.09.2026;
- Raporti i Ekspertit Shqyrtues dhe Vendimi i OSHP-së nr. **2025/0780**;

- Raporti i Ekspertit Shqyrtues dhe Vendimi i OSHP-së nr. 2025/1198.

Përfundimi dhe kërkesa. Duke u bazuar në faktet, argumentet, bazën ligjore dhe provat e paraqitura më sipër, kërkojmë nga OSHP që këtë pretendim ta aprovojë si të bazuar dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që **Aneksin 1 ta plotësojë para ofertimit me kërkesa minimale, fushëveprim të përcaktuar dhe kufij maksimalë të matshëm për format/proceset dhe kërkesat e reja, Backend/API/endpoint-et, integritet, avancimet teknologjike, SLA-të, trajnimet, rezultatet e dorëzueshme dhe kriteret objektive të pranimit, në mënyrë që të gjithë OE-të të planifikojnë resurset dhe të kalkulojnë ofertat mbi baza të njëjta dhe të krahasueshme.**

V. Kërkesa drejtuar OSHP-së

Duke u bazuar në faktet, argumentet, bazën ligjore dhe provat e paraqitura në këtë ankesë, kërkojmë nga OSHP që:

1. Ta aprovojë ankesën si të bazuar;
2. Ta anulojë Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 04.09.2026, **në pjesën me të cilën janë refuzuar pretendimet e PBC-së;**
3. Ta obligojë AK-në që, për pozitat e kontestuar, të pranojë **diplomën Bachelor në drejtimet relevante ose ekuivalente si kusht minimal arsimor**, krahas përvojës profesionale të kërkuar për secilën pozitë, si dhe ta harmonizojë qartë kriterin për Web Services/Web API në FDT me Vendimin e datës 04.09.2026;
4. Ta obligojë AK-në ta rishikojë numrin dhe konfigurimin e stafit dhe të mundësojë kombinimin e roleve kur i njëjti ekspert i plotëson kriteret dhe kompetencat e kërkuara, përveç rasteve kur nevoja për profile të ndara arsyetohet me detyra dhe ngarkesë konkrete e të matshme;
5. Ta obligojë AK-në ta largojë **ISO/IEC 20000-1:2018 si kriter eliminues**, përveç nëse arsyeton dhe dëshmon konkretisht domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e tij me detyrat e kontratës, si dhe kërkesat për certifikime t'i lidhë me pjesën konkrete të shërbimit që realizon anëtari përkatës i grupit;
6. Ta obligojë AK-në që **Aneksin 1 ta plotësojë para ofertimit me kërkesa minimale, fushëveprim të përcaktuar dhe kufij maksimalë të matshëm**, duke përfshirë parametrat teknikë, integritet, Backend/API/endpoint-et, SLA-të, trajnimet, rezultatet e dorëzueshme dhe kriteret objektive të pranimit;
7. Ta obligojë AK-në të publikojë **Dosjen e Tenderit të korrigjuar dhe të harmonizuar me vendimin e OSHP-së** dhe të caktojë afat të ri për ofertim në përputhje me afatet ligjore pas ndryshimeve;
8. Ta mbajë aktivitetin e prokurimit të pezulluar deri në vendosjen përfundimtare lidhur me këtë ankesë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale dhe jomateriale që i janë shkaktuar ose që mund t'i shkaktohen parashtruesit si pasojë e shkeljeve të pretenduara do të përcaktohen pas realizimit të një ekspertize përkatëse financiare.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*